



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË BARAZISË GJINORE

Nr. 3184 Prot.

Ballsh, më 24.06.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 30 Datë 24.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
NË BASHKINË MALLAKASTËR 2026-2031**

KËSHILLI TË BASHKISË

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, të ligjit nr 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ligjit nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë, të VKM-së nr.400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore,2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit, Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore”, nënshkruar në janar 2025 nga ana e Bashkisë Mallakastër si dhe të urdhërit nr. 195, datë 15.05.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër”,

PROPOZOI:

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër 2026-2031, sipas dokumentit bashkëliqitur, për të përmbledhëse të këtij projekt-vendimi.
2. Ky plan ka karakter ndërsektorial dhe ngarkon me përgjegjësi direkte për zbatimin e tij të gjitha drejtoritë e Bashkisë Mallakastër dhe institucionet në varësi të saj
3. Ky Projekt-vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Cerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI

Nr. 3184 / Prot.

Ballsh, më 24.06.2026

Mirator
Zv/Kryetar
Etilda Dishaj



**RELACION SHPJEGUES MBI PROJEKT- VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E
PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE NË BASHKINË
MALLAKASTËR 2026-2031”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, si dhe të urdhërit nr. 195, datë 15.05.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër”, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, si dhe në përmbushje të misionit të vetëqeverisjes vendore për një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, Bashkia Mallakastër ka iniciuar projekt-vendimin “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër 2026-2031”. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave të tyre mund të ndërmarrin nisma me interes publik në territorin nën juridiksionin e tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj.

Ky relacion shpjegues për hartimin e një Plani të Veprimit të Barazisë Gjinore shërben për të argumentuar nevojën e këtij dokumenti dhe për të përcaktuar objektivat, masat dhe buxhetin për integrimin e perspektivës gjinore.

Qëllimi kryesor i këtij plani është garantimi i mundësive dhe trajtimit të barabartë mes grave dhe burrave, si dhe eliminimi i diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore.

Dokumenti analizon treguesit kryesorë gjinorë përmes të dhënave të ndara sipas gjinisë. Ai identifikon hendekun dhe sfidat në fushat thelbësore, si:

- Pjesëmarrja në tregun e punës dhe nivelet e pagave.
- Përfaqësimi në vendimmarrje dhe pozitat drejtuese.
- Qasja në shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore.
- Masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore.

Plani i Barazisë Gjinore fokusohet në arritjen e synimeve strategjike për periudhën 2026-2031, të cilat ndahen në:

- **Fuqizimi ekonomik:** Mbështetja e grave në sipërmarrje dhe rritja e punësimit.
- **Vendimmarrja:** Promovimi i barazisë në institucionet publike dhe private.
- **Dhuna me bazë gjinore:** Forcimi i mekanizmave të referimit dhe mbështetja e viktimave.
- **Ndërgjegjësimi publik:** Nxitja e edukimit gjinor dhe ndryshimi i stereotipeve.

Relacioni përcakton se Plani shoqërohet me një matricë të detajuar veprimesh. Për secilin objektiv përcaktohen:

- Aktivitetet specifike që duhet të ndërmerren.
- Institucionet përgjegjëse për zbatimin.
- Afatet kohore të realizimit.
- Indikatorët e matshëm të performancës për vlerësimin e rezultateve.

Për zbatimin efektiv të aktiviteteve të parashikuara në plan, relacioni evidenton kostot përkatëse. Këto masa mbulohen nga buxheti i miratuar i institucionit/bashkisë dhe nga fonde të mundshme të alokuara për llogari të Bashkisë Mallakastër.

Rëndësia e një Plani Veprimi për Barazinë Gjinore (PBCJ) nuk duhet parë vetëm në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe përafruese me legjislacionin e BE, pasi ky plan është jetike sepse ai kthen parimet teorike të ligjit në veprime konkrete, të matshme dhe me buxhet të dedikuar. Pa këtë plan, angazhimet për barazi mbeten thjesht deklarata vullneti pa ndikim real në jetën e qytetarëve.

Rëndësia e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore:

- **Rritje e punësimit:** Aktivizon forcën e punës të grave.
- **Luftë kundër varfërisë:** Fuqizimi ekonomik i grave ul drejtpërdrejt nivelet e varfërisë në komunitet.
- **Përdorim i drejtë i fondeve:** Integron buxhetimin me bazë gjinore, duke siguruar që paratë publike t'i shërbejnë njëlloj burrave dhe grave.
- **Përfaqësim i balancuar:** Siguron që zëri i grave të dëgjohej në pozicionet drejtuese dhe në hartimin e politikave.
- **Shërbime publike më të mira:** Shërbimet (si çerdhet, kopshtet, ndriçimi publik) dizajnohen duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të të dyja gjinive.
- **Transparencë dhe llogaridhënie:** Institucionet monitorohen me tregues të qartë se sa po punojnë për barazinë.
- **Lufta ndaj dhunës:** Forcon mekanizmat vendorë dhe qendrorë për parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave.
- **Eliminimi i stereotipeve:** Edukon brezat e rinj dhe komunitetin kundër roleve tradicionale kufizuese dhe diskriminimit.
- **Drejtësi sociale:** Ndërton një shoqëri ku profesioni, paga dhe mundësitë nuk kushtëzohen nga gjinia.
- **Detyrim ligjor:** Përmbush kërkesat e kuadrit ligjor vendas për barazinë gjinore.
- **Integrimi Evropian:** Plotëson kritere të Bashkimit Evropian.
- **Qasje në fonde:** Shumë donatorë ndërkombëtarë dhe fonde të BE-së e kanë kusht ekzistencën e një plani gjinor për të dhënë grante.

Miratimi i këtij plani për pesë vitet e ardhshme dëshmon angazhimin e Bashkisë Mallakastër për një zhvillim të drejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës, në edukimin e brezave të rinj, vlersimin e punës rurale, si dhe prinderimin e përbashkët, duke lehtësuar ngarkesën emocionale dhe fizike të grave.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli Bashkiak shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Mallakastër 2026–2031.

GRUPI I PUNËS


Naime Dervishaj



Jonida Llaça



Kleidja Hoxhaj



Aurora Heqimaj

Aurora Veizaj





PLANI VENDOR I VEPRIMIT

PËR BARAZINË GJINORE

2026 – 2031

Përgatitur nga Bashkia Mallakastër
në kuadër të zbatimit të
Kartës Evropiane për Barazi
të grave dhe burrave në jetën vendore

Maj 2026

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2031 u përgatit nga Bashkia Mallakastër me mbështetjen e Eksperteve të Barazisë Gjinore në kuadër të zbatimit të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian

Grupi i Punës


Znj. Naime Dervishaj

Znj. Aurora Heqimaj

Znj. Kleidja Hoxhaj

Znj. Jonida Llaka

Znj. Aurora Veizaj



Drejtoreshë e Kultures

Specialist /Sektori Juridik

Pergjegjese Sektori Çështjeve Sociale

P/Sektori Burimeve Njerezore

Specialist Sektori i Çështjeve Sociale

Ekspertiza teknike
Edisnajda Feimi

Eksperte e Barazisë Gjinore

Tabela e Permbajtjes

Tabela e Permbajtjes	4
Lista e Shkurtimeve	5
1.KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL.....	8
1.1. Instrumentet ndërkombëtare	9
2.METODOLOGJIA.....	12
2.1.Metodologjia e Hartimit të PVVBGJ 2026–2031	12
3.Qasja Metodologjike për Zbatimin dhe Monitorimin	13
3.1.1 Punësimi dhe sfidat ekonomike	16
4..VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	19
- Fuqizimi ekonomik dhe social	19
5.1 Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe punësimit të denjë dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave.....	21
Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje	22
6. KOSTIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2031	24
7. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	27
SHTOJCA 1.....	30
MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE (PVVBGJ) 2026–2031.....	30
SHTOJCA 2.....	31
PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	31
SHTOJCA 3.....	32
TABELA E DETAJUAR E KOSTIMIT	32
SHTOJCA 4.....	33
LISTA E INSTITUCIONEVE DHE PARTNERËVE.....	33

Tabela e figurave

Figure 1.Gjinia	14
Figure 2. Vendbanimi.....	15
Figure 3. Moshë.....	15
Figure 4. Barazia në punësim	16
Figure 5. Gatishmeria për hapje biznesi	17
Figure 6. Pengesat kryesore.....	17
Figure 7. Përqindja e kostos sipas fushave	26
Figure 8. Ndarja e kostos sipas burimit	27

Lista e Shkurtimeve

Akronimi	Përshkrimi
AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAË	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAB	Drejtoria e Auditit të Brendshëm
DANJAAMTP	Drejtoria e Administrimit të NJA dhe AMTP
DB	Drejtoria e Buxhetit
DEC	Drejtoria e Emergjencave Civile
DF	Drejtoria e Financës
DDH	Drejtoria e të Dhënave
DI	Drejtoria e Inovacionit
DIEPH	Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Projekteve të Huaja
DIPN	Drejtoria e Inovacionit dhe Projekteve Natyrore
DJ	Drejtoria Juridike
DKD	Drejtoria e Koordinimit me Donatorët
DKQ	Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët
DKSSHI	Drejtoria e Kujdesit Social dhe Shërbimet e Integruara
DKTK	Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore
DLGJC	Drejtoria e Licencimit dhe Gjendjes Civile
DMK	Drejtoria e Medias dhe Komunikimit
DMPS	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
DMTTV	Drejtoria e Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore
DNKRRN	Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike dhe Rreziqeve Natyrore

Akronimi	Përshkrimi
DNP	Drejtoria e Nxitjes së Punësimit
DPEM	Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor
DPLA	Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore
DPZHIT	Drejtoria e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit
DR	Drejtoria e Rinisë
DREC	Drejtoria e Rindërtimit të Emergjencave Civile
DRSHS	Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale
DS	Drejtoria e Sportit
DSS	Drejtoria e Strehimit Social
DTIK	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
DTTRR	Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor
DTZH	Drejtoria e Trajnimit dhe Zhvillimit
DVPMAMS	Drejtoria e Vlerësimit të Performancës, Masave Administrative dhe Motivimit të Stafit
DZHER	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural
DZHEU	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
KBGJ	Komisioni për Barazinë Gjinore
KBRE	Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës
KV	Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OS	Objektivi Specifik
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021–2031)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

Hyrje

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2031 është dokumenti strategjik dhe operacional i Bashkisë Mallakastër për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e barazisë gjinore në nivel vendor. Plani hartohet në funksion të zbatimit të angazhimeve të marra nga Bashkia Mallakastër përmes nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të promovuar nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (CEMR), si dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Nëpërmjet këtij angazhimi, Bashkia Mallakastër synon të sigurojë integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikatat, programet dhe shërbimet vendore, duke garantuar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe për të gjitha grupet shoqërore. PVVBGJ përbën instrumentin kryesor për transformimin e këtyre angazhimeve në veprime konkrete, të matshme dhe të qëndrueshme.

Hartimi i planit është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, i zhvilluar në bashkëpunim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, median, sektorin privat, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Procesi është mbështetur nga Bashkia Mallakastër dhe Grupi i Ekspertëve për Barazinë Gjinore në kuadër të projektit “Zbatimi i Kuadrit Ligjor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore” (EU4GE).

Plani bazohet në parimin se barazia gjinore është një e drejtë themelore e njeriut dhe një kusht i domosdoshëm për zhvillimin demokratik, social dhe ekonomik të qëndrueshëm. Barazia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat gëzojnë të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta në të gjitha aspektet e jetës, pa u kufizuar nga stereotipet, normat apo rolet tradicionale gjinore.

Si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve, Bashkia Mallakastër ka një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe adresimin e pabarazive gjinore, në promovimin e përfshirjes sociale dhe në garantimin e aksesit të barabartë në shërbime publike. Gjatë viteve të fundit, bashkia ka ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e shërbimeve sociale, fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të

grave dhe vajzave, mbështetjen e grupeve të cënueshme dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Megjithatë, pavarësisht progresit të arritur, pabarazitë gjinore dhe format e ndryshme të diskriminimit vazhdojnë të ndikojnë në jetën e qytetarëve. Stereotipet gjinore, pabarazitë në tregun e punës, përfaqësimi i kufizuar në vendimmarrje, dhuna me bazë gjinore dhe sfidat në aksesin ndaj mundësive ekonomike e sociale mbeten çështje që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe ndërhyrje të koordinuar institucionale.

Në këtë kontekst, PVVBGJ 2026–2031 synon të forcojë qasjen e integruar gjinore në qeverisjen vendore, duke kaluar nga trajtimi i pjesshëm i çështjeve gjinore drejt përfshirjes sistematike të perspektivës gjinore në planifikim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të politikave publike. Një rëndësi e veçantë i kushtohet përdorimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe faktorëve të tjerë socialë, si bazë për vendimmarrje të informuar dhe politika më efektive.

Plani adreson gjithashtu nevojat specifike të grupeve më të cënueshme, përfshirë gratë dhe vajzat në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara, familjet në vështirësi socio-ekonomike dhe individët që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan janë të organizuara në objektiva strategjike dhe specifike, të shoqëruar me tregues të matshëm, institucione përgjegjëse, afate kohore dhe burime të identifikuara. Në këtë mënyrë, PVVBGJ 2026–2031 synon të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet në zbatimin e politikave për barazinë gjinore, duke kontribuar në ndërtimin e një komuniteti më të drejtë, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Bashkisë Mallakastër.

1.KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim përbën një nga parimet themelore të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës garanton barazinë e të gjithë shtetasve përpara ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, etnisë, gjuhës, fesë, bindjeve politike apo filozofike, gjendjes ekonomike, sociale apo arsimit. Kjo dispozitë përbën bazën mbi të cilën ndërtohet kuadri ligjor dhe institucional për promovimin e barazisë gjinore në vend.

Përveç legjislacionit kombëtar, Shqipëria ka ratifikuar një sërë instrumentesh ndërkombëtare që garantojnë dhe promovojnë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm dhe përbëjnë referenca të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e politikave publike në nivel kombëtar dhe vendor.

1.1. Instrumentet ndërkombëtare

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2031 mbështetet në instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, ndër të cilat:

- Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË);
- Deklarata dhe Platforma e Veprimit e Pekinit;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht Objektivi 5 për Barazinë Gjinore;
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian (EU GAP III);
- Dokumente dhe standarde të tjera ndërkombëtare që promovojnë të drejtat e grave, fuqizimin ekonomik dhe politik të tyre dhe eliminimin e diskriminimit gjinor.

1.1.1. Kuadri ligjor kombëtar

PVVBGJ 2026–2031 mbështetet në legjislacionin shqiptar që rregullon barazinë gjinore, mbrojtjen sociale, përfshirjen, punësimin, arsimin, pjesëmarrjen qytetare dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna. Ndër aktet më të rëndësishme ligjore përmenden:

- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligjin 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar
- Ligji nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”
- Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”
- Ligji 22/2018 “Për strehimin social”
- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”
- Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.
- Ligji i ri “Për Barazinë Gjinore”, miratuar në vitin 2025.

1.1.2.Politikat kombëtare

PVVBJ 2026–2031 është i harmonizuar me kuadrin strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar për barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dokumentet kryesore referuese për hartimin dhe zbatimin e këtij plani janë:

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029;
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agenda 2030), veçanërisht Objektivi 5 për Barazinë Gjinore;
- Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË);
- Konventa e Stambollit;
- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian (EU GAP III 2021–2027);
- Dokumentet strategjike dhe sektoriale të Bashkisë Mallakastër.

Gjithashtu, plani merr në konsideratë zhvillimet më të fundit të kuadrit ligjor shqiptar, përfshirë Ligjin e ri për Barazinë Gjinore të miratuar në vitin 2025, si dhe reformat në fushën e parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Këto zhvillime synojnë forcimin e mekanizmave institucionalë, garantimin e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

1.1.3.Institucionet përgjegjëse

Në përputhje me Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, Bashkia Mallakastër është institucioni përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e PVVBGJ 2026–2031. Përgjegjësia e bashkisë përfshin si realizimin e drejtpërdrejtë të masave që bien në kompetencën e saj, ashtu edhe koordinimin ndërinstitucional me aktorët përgjegjës në nivel vendor dhe qendror.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Nëpunësi/ja i/e Barazisë Gjinore (NBGJ), i cili siguron koordinimin institucional të politikave dhe veprimeve për barazinë gjinore në nivel vendor, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjithashtu, në zbatimin e planit kontribuojnë:

- Këshilli Bashkiak;
- Komisioni për Barazinë Gjinore;
- Aleanca e Grave Këshilltare;
- Drejtoritë dhe strukturat e Bashkisë Mallakastër;
- Njësitë Administrative;
- Institucionet arsimore, shëndetësore dhe sociale;
- Organizatat e shoqërisë civile;
- Organizatat ndërkombëtare dhe partnerët e zhvillimit;
- Sektori privat dhe grupet komunitare.

Për të siguruar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, Bashkia Mallakastër do të forcojë mekanizmat e koordinimit ndërsektorial dhe do të promovojë integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha dokumentet strategjike, programet dhe proceset e planifikimit vendor.

Pjesëmarrja aktive e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit dhe partnerëve të zhvillimit mbetet thelbësore për arritjen e objektivave të këtij plani dhe për avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore në territorin e Bashkisë Mallakastër.

Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të Drejtorive kryesore përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan.

Ky Komision, do të mundësonte një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për avancimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave dhe arritjen e barazisë gjinore (psh ky Komision do të mundësonte përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha dokumentat zhvillimore të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në avancimin drejt barazisë gjinore.

Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

2.METODOLOGJIA

2.1.Metodologjia e Hartimit të PVVBGJ 2026–2031

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2031 u mbështet në një proces gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të bazuar në evidenca, në përputhje me metodologjinë e rekomanduar nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE) për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Përveç analizës së dokumentacionit ekzistues dhe konsultimeve me aktorët vendorë, procesi i hartimit të PVVBGJ 2026–2031 u mbështet edhe në rezultatet e një pyetësoi të strukturuar, të administruar me qytetarë të Bashkisë Mallakastër. Pyetësoi shërbeu si instrument për mbledhjen e të dhënave primare mbi perceptimet, përvojat dhe nevojat e grave dhe burrave në komunitet lidhur me barazinë gjinore, pjesëmarrjen në jetën publike, aksesin në shërbime dhe sfidat e zhvillimit social e ekonomik. Gjetjet e pyetësorit u përdorën për identifikimin e prioriteteve, përcaktimin e objektivave dhe hartimin e masave të planit.

Procesi i hartimit u zhvillua nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- **Ngritja e Grupit të Punës**

Grupi i Punës për hartimin e PVVBGJ 2026–2031 u ngrit me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 195, datë 15.05.2026, “Për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2031”. Grupi i punës përfshiu përfaqësuese dhe përfaqësues të strukturave kryesore të bashkisë dhe siguroi një përfaqësim të balancuar gjinor.

- **Analiza e situatës ekzistuese**

Hartimi i planit u mbështet në analizën e dokumenteve strategjike, statistikore dhe institucionale ekzistuese në nivel vendor dhe kombëtar. Analiza përfshiu dokumentet zhvillimore të Bashkisë Mallakastër, raportet sektoriale, të dhënat administrative, kuadrin ligjor dhe politikat kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

- **Identifikimi i prioriteteve dhe fushave të ndërhyrjes**

Bazuar në analizën e situatës dhe në konsultimet e zhvilluara me aktorët vendorë, u identifikuan prioritetet kryesore dhe fushat strategjike të ndërhyrjes që përbëjnë bazën e objektivave dhe masave të këtij plani.

- **Konsultimet institucionale**

U zhvilluan takime konsultative me drejtues dhe specialistë të drejtorive të Bashkisë Mallakastër, si dhe me administratorët e Njësiave Administrative. Këto konsultime synuan rritjen e njohurive mbi Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, identifikimin e sfidave ekzistuese dhe diskutimin e prioriteteve të planit.

- **Konsultimet me partnerët vendorë**

Procesi përfshiu konsultime me organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike, përfaqësues të komunitetit, Aleancën e Grave Këshilltare, Këshillin Bashkiak, sektorin privat dhe aktorë të tjerë vendorë. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë këtyre konsultimeve u reflektuan në draftin e planit.

- **Hartimi dhe konsultimi publik i draftit**

Drafti i PVVBGJ 2026–2031 u përgatit mbi bazën e analizës së situatës dhe rezultateve të konsultimeve. Dokumenti përfshiu vizionin, objektivat strategjike dhe specifike, masat, aktivitetet, treguesit e performancës, institucionet përgjegjëse dhe kostot përkatëse.

Drafti iu nënshtrua procesit të konsultimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër dhe duke u shpërndarë tek institucionet dhe partnerët relevantë për marrjen e komenteve dhe sugjerimeve.

- **Kostimi dhe finalizimi i planit**

Pas përfundimit të konsultimeve, u realizua kostimi i aktiviteteve dhe masave të planifikuara në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit u integruan në versionin përfundimtar të dokumentit.

- **Miratimi dhe publikimi**

Versioni përfundimtar i PVVBGJ 2026–2031 iu paraqit për miratim Këshillit Bashkiak. Pas miratimit, dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër dhe bëhet pjesë e dokumenteve strategjike të bashkisë për periudhën 2026–2031.

Hartimi i planit u mbështet nga ekspertë të barazisë gjinore në kuadër të projektit “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri II – Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri (EU4GE II)”, financuar nga Bashkimi Evropian.

3.Qasja Metodologjike për Zbatimin dhe Monitorimin

Zbatimi i PVVBGJ 2026–2031 do të bazohet në një qasje të integruar, ndërsektoriale dhe të orientuar drejt rezultateve, me synim përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe shërbimet e Bashkisë Mallakastër.

Një element i rëndësishëm i metodologjisë së zbatimit është përdorimi sistematik i të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe karakteristikave të tjera sociale, për të mbështetur planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Për këtë qëllim, Bashkia Mallakastër do të përdorë instrumente të ndryshme të mbledhjes dhe analizës së informacionit, duke përfshirë anketa, pyetësorë, konsultime publike, fokus-grupe dhe

të dhëna administrative. Një nga instrumentet kryesore do të jetë zhvillimi periodik i pyetësorëve për vlerësimin e perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve lidhur me barazinë gjinore.

Këto instrumente do të mundësojnë:

- identifikimin e perceptimeve të komunitetit mbi barazinë gjinore dhe stereotipet gjinore;
- vlerësimin e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në jetën ekonomike, sociale dhe vendimmarrëse;
- evidentimin e pengesave që kufizojnë përfshirjen e grave dhe vajzave në komunitet;
- mbledhjen e të dhënave të nevojshme për monitorimin e treguesve të planit;
- përmirësimin e vendimmarrjes së bazuar në evidenca.

Monitorimi i zbatimit të planit do të realizohet në mënyrë periodike nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me Komisionin për Barazinë Gjinore, Këshillin Bashkiak, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e zhvillimit.

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit do të shërbejnë si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve të synuara, si dhe për monitorimin e progresit në zbatimin e PVVBGJ. Ato do të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e politikave vendore dhe në rritjen e efektivitetit të masave për barazinë gjinore. Përveç pyetësorit, metodologjia përfshin gjithashtu trajnime, konsultime publike, takime me komunitetin, bashkëpunim ndër-institucional dhe përdorimin e treguesve të ndjeshëm gjinorë për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm

3.1 Analiza e të dhënave

Nga të dhënat rezulton se:

- Pjesa dërrmuese e të anketuarve janë **femra**, ndërsa meshkujt përfaqësohen në mënyrë më të kufizuar.



Figure 1.Gjinia




Figure 2. Vendbanimi

- Shumica jetojnë në **zona urbane**, por një pjesë e rëndësishme vjen edhe nga zonat rurale, duke lejuar krahasim të perceptimeve.



Figure 3. Mosha

- Grupmoshat më të përfaqësuara janë **25-34 dhe 35-44 vjeç**, pra popullsia aktive në tregun e punës.

3.1.1 Punësimi dhe sfidat ekonomike

Të gjithë pjesëmarrësit janë kryesisht të **punësuar**, megjithatë përgjigjet cilësore tregojnë sfida strukturore:

- Si pengesë kryesore për punësimin e grave dhe sipërmarrjen përmenden:
 - **mungesa e financimit**
 - **mungesa e vendeve të punës**
 - **përgjegjësitë familjare**
 - **diskriminimi gjinor dhe stereotipet**
- Mundësitë e barabarta në punësim vlerësohen shpesh si:
 - “pjesërisht të barabarta” ose “jo plotësisht të barabarta”




Figure 4. Barazia ne punesim

Kjo tregon ekzistencën e një **barazie formale**, por jo domosdoshmërisht **barazi reale në praktikë**

Trajnimi dhe sipërmarrja

- Pjesëmarrja në **trajnim profesional** është e kufizuar ose e pjesshme.
- Shumica e të anketuarve janë të gatshëm të hapin biznes, por pengohen nga:
 - mungesa e financimit
 - mungesa e mbështetjes institucionale
 - pasiguria ekonomike




Figure 5. Gatishmeria per hapje biznesi

Kjo tregon potencial të lartë për sipërmarrje, por mungesë të mekanizmave mbështetës.




Figure 6. Pengesat kryesore

Rezultatet e paraqitura në grafikë sugjerojnë se barazia gjinore në Bashkinë Mallakastër është në një fazë përmirësimi të pjesshëm, por jo të konsoliduar.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja në komunitet

- Një pjesë e madhe e grave **nuk janë pjesë aktive e strukturave komunitare.**
- Përfaqësimi i grave në vendimmarrje vlerësohet kryesisht si:
 - **i pamjaftueshëm**
- Shumë të anketuar shprehin dëshirë për përfshirje më të madhe.

Kjo tregon një hendek të qartë gjinor në vendimmarrjen lokale.

Stereotipet dhe diskriminimi gjinor

- Shumica e të anketuarve pranojnë ekzistencën e stereotipeve gjinore.
- Ato shfaqen kryesisht në:
 - familje
 - komunitet
 - vendin e punës
- Disa përgjigje përmendin edhe:
 - diskriminim në punësim
 - mungesë përkrahjeje institucionale

Siguria dhe dhuna në familje

Një pjesë e mirë e të anketuarve deklarojnë se ndihen të sigurt, por jo të gjithë.

Njohuritë mbi institucionet për dhunën në familje janë të pjesshme.

Efektiviteti i institucioneve vlerësohet shpesh si:

“pjesërisht efektiv” ose “jo mjaftueshëm efektiv”

Kjo tregon nevojë për forcim të mekanizmave të mbrojtjes sociale dhe informimit publik.

Shërbimet prioritare që duhen përmirësuar

Fushat prioritare të ndërhyrjes janë

- **Punësimi** (kryesori absolut)
- **Mbrojtja nga dhuna në familje**
- **Arsimi dhe trajnimi profesional**
- **Shërbimet sociale**
- **Infrastruktura dhe shërbimet rurale**
- **Siguria publike dhe transporti**
- **Punësimi dhe krijimi i vendeve të punës**
- **Mbështetja për sipërmarrjen femërore**
- **Zgjerimi i trajnimeve profesionale**
- **Forcimi i mekanizmave kundër stereotipeve gjinore**

Rezultatet e paraqitura në grafikë sugjerojnë se barazia gjinore në Bashkinë Mallakastër është në një fazë përmirësimi të pjesshëm, por jo të konsoliduar.

4..VIZIONI, FUSHAT E NDËRHJRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër është:

“Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Mallakastrës, pavarësisht moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike e sociale, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit civil, statusit të punësimit dhe gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë të drejta të barabarta, respektohen dhe kontribuojnë në mënyrë të barabartë në zhvillimin e shoqërisë dhe në përparimin drejt barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës.”

Parimet udhëheqëse të PVVBGJ

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore mbështetet në parimet e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të cilat përfshijnë:

- Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejtave dhe të rinjve, përbën një të drejtë themelore dhe të patjetërsueshme;
 - Trajtimi i pabarazive kërkon adresimin e diskriminimit dhe pengesave të shumëfishta që prekin grupet e ndryshme sociale;
 - Pjesëmarrja e balancuar në vendimmarrje është kusht thelbësor për një shoqëri demokratike dhe gjithëpërfshirëse;
 - Eliminimi i stereotipeve gjinore është i domosdoshëm për arritjen e barazisë reale;
 - Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe veprimtaritë vendore është një kërkesë bazë për qeverisje të mirë;
 - Planet e veprimit të mbështetura me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare janë instrumente thelbësore për arritjen e rezultateve konkrete.
- **Fushat kryesore të ndërhyrjes**

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2031 është strukturuar në katër, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021- 2031, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- Fuqizimi ekonomik dhe social

Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejtave dhe grave në të gjitha format e tyre të diversitetit, përmes:

- rritjes së aksesit në punësim të denjë;
- mbështetjes së sipërmarrjes femërore;

- përmirësimit të aftësive profesionale dhe trajnimeve.

Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.

- Pjesëmarrja në vendimmarrje

Rritja e përfaqësimit të grave dhe të rinjve në proceset e vendimmarrjes politike dhe publike në nivel vendor, përmes:

- forcimit të pjesëmarrjes në struktura lokale;
- promovimit të lidershit të grave dhe vajzave;
- krijimit të mundësive të barabarta për angazhim publik.

- Mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore

Garantimi i një mjedisi të lirë nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje, përmes:

- forcimit të mekanizmave të mbrojtjes dhe referimit;
- përmirësimit të aksesit në shërbime mbështetëse;
- ndërgjegjësimit të komunitetit dhe institucioneve.

- Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Zbatimi, koordinimi dhe qëndrueshmëria

Zbatimi efektiv i PVVBGJ kërkon:

- sigurimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore;
- koordinim të ngushtë ndërinstitucional me aktorët vendorë dhe qendrorë;

- bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median dhe partnerët ndërkombëtarë.

Gjithashtu, është thelbësore:

- mbledhja dhe përditësimi i rregullt i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë socialë;
- monitorimi i vazhdueshëm i progresit;
- transparencja dhe llogaridhënia institucionale për rezultatet e arritura.

5. REZULTATET E PRITSHME, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE TREGUESIT

5.1 Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe punësimit të denjë dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave

Rezultatet e pritshme

- Veprimet e Bashkisë Mallakastër për nxitjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave në të gjithë diversitetin e tyre përmirësohen ndjeshëm.
- Masat për nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave përshtaten me nevojat specifike dhe zbatohen në mënyrë efektive.

Objektivi specifik I

Rritja e aksesit të grave dhe të rejave në shërbime, mundësi punësimi, sipërmarrje dhe burime financiare që kontribuojnë në fuqizimin e tyre ekonomik.

Treguesit

- Numri i grave dhe të rejave përfutuese nga programet e formimit profesional, i ndarë sipas moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike/kulturore dhe aftësisë së kufizuar.
- Numri i ndërmarrjeve të reja të themeluara ose të drejtuara nga gra dhe të reja që kanë përfituar mbështetje financiare nga Bashkia Mallakastër gjatë zbatimit të PVVBGJ, i ndarë sipas sektorëve ekonomikë.

5.1.1 Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimmarrjen politike dhe publike

1.

Rezultatet e pritshme

- Rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimarrjen publike dhe politike në nivel vendor.
- Aktivitetet për pjesëmarrje në vendimarrje adresojnë stereotipet gjinore dhe nxisin përfshirje gjithëpërfshirëse.
- Veprimet e Bashkisë Mallakastër forcojnë zbatimin e legjislacionit për barazi dhe përfaqësim të drejtë.

Objektivi specifik II

Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimarrjen politike dhe publike në nivel vendor.

Treguesit

- Numri i grave dhe të rejave të trajnuara për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe integrimin gjinor në vendimarrje.
- Përqindja e grave dhe të rejave në pozicione drejtuese në Bashkinë Mallakastër, Këshillin Bashkiak, njësitë administrative dhe këshillat lokalë.

Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje

Rezultatet e pritshme

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore fuqizohet dhe bëhet më efikas.
- Një brez i ri më i ndërgjegjshëm për barazinë gjinore angazhohet në luftën kundër stereotipeve dhe diskriminimit.
- Komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të mbrojtura nga dhuna.

Objektivat specifike III

- Fuqizimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.
- Reduktimi i stereotipeve gjinore dhe praktikave të dëmshme përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit.
- Fuqizimi i grave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, në përputhje me agjendat “Gruaja, Paqja dhe Siguria” dhe “Rinia, Paqja dhe Siguria”.

Treguesit

- Numri i rasteve të dhunës në familje të referuara dhe të trajtuara nga MKR në raport me rastet e regjistruara.
- Përqindja e buxhetit të Bashkisë Mallakastër të dedikuar për shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës.
- Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

- Përqindja e grave, të rejave dhe të rinjve të përfshirë në aktivitete për paqe, siguri dhe komunitete gjithëpërfshirëse.

5.1.4. Integrimi gjinor në politikat vendore

Rezultatet e pritshme

- Rritje e transparencës dhe llogaridhënies së Bashkisë Mallakastër në zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore.
- Zbatim efektiv i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe programet vendore.

Objektivat specifike IV

- Rritja e transparencës dhe monitorimit të politikave të barazisë gjinore.
- Zbatimi i integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

Treguesit

- Numri i raporteve të monitorimit të PVVBGJ të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe të publikuara zyrtarisht.
- Numri i programeve buxhetore të analizuara me perspektivë gjinore.
- Përqindja e buxhetit vjetor të Bashkisë Mallakastër të dedikuar për zbatimin e PVVBGJ dhe trendi i saj në rritje.

Këta objektiva dhe tregues krijojnë një kuadër të matshëm dhe të monitorueshëm për zbatimin efektiv të politikave të barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër, duke siguruar progres të qëndrueshëm në fuqizimin ekonomik, pjesëmarrjen publike, mbrojtjen sociale dhe integrimin gjinor.

6. KOSTIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2031

Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Matricën e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2031 kërkon sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për realizimin e objektivave dhe masave të planifikuara. Vlerësimi financiar i planit është kryer për të përcaktuar koston e përgjithshme të zbatimit dhe burimet potenciale të financimit gjatë periudhës 2026–2031.

Kostoja totale e planit është ndarë në tre kategori kryesore financimi:

- Kontributi i Bashkisë Mallakastër;
- Financimi nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë;
- Hendeku financiar i pambuluar në momentin e miratimit të planit.

Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve do të realizohen përmes burimeve ekzistuese të Bashkisë Mallakastër, duke përfshirë stafin aktual, infrastrukturën institucionale, pajisjet logjistike dhe materialet administrative. Këto kontribute konsiderohen si kontribute në natyrë (in-kind) dhe janë përfshirë në vlerësimin e përgjithshëm të kostove.

Përlllogaritjet financiare janë bazuar në koston minimale të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës së zbatimit 2026–2031.

6.1 Struktura e kostimit

Për secilën masë dhe aktivitet të parashikuar në PVVBGJ është përlllogaritur kostoja financiare sipas komponentëve të mëposhtëm:

Kostoja totale e aktivitetit

Kostoja totale është përlllogaritur mbi bazën e koston për njësi dhe numrit të aktiviteteve të planifikuara përgjatë periudhës së zbatimit të planit.

Kontributi i Bashkisë Mallakastër

Kontributi i Bashkisë përfshin:

- angazhimin e stafit ekzistues në kuadër të detyrave funksionale;
- përdorimin e ambienteve dhe infrastrukturës institucionale;
- përdorimin e mjeteve logjistike dhe pajisjeve ekzistuese;
- kontribute të tjera në natyrë.

- Kontributi i donatorëve dhe partnerëve

Ky komponent përfshin financimet e siguruar ose të pritshme nga donatorë, organizata partnere dhe institucione mbështetëse.

- **Hendeku financiar**

Hendeku financiar përfaqëson pjesën e kostos së aktiviteteve që mbetet e pambuluar dhe për të cilën do të nevojitet mobilizimi i burimeve shtesë financiare.

- **Burimet e financimit dhe fleksibiliteti buxhetor**

Miratimi i PVVBGJ 2026–2031 nuk garanton automatikisht financimin e plotë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara. Për këtë arsye, Bashkia Mallakastër do të synojë integrimin gradual të masave dhe aktiviteteve të planit në:

- Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- buxhetet vjetore të Bashkisë;
- projektet dhe marrëveshjet me donatorët dhe partnerët zhvillimorë.

Angazhimi i strukturave vendore, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë mbetet thelbësor për sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për zbatimin e plotë të planit.

- **Rishikimi dhe monitorimi i kostove**

Kostot e paraqitura në këtë plan janë orientuese dhe do t'i nënshtrohen rishikimit periodik në përputhje me:

- progresin e zbatimit të aktiviteteve;
- ndryshimet në kuadrin buxhetor të Bashkisë;
- mundësitë e reja të financimit;
- marrëveshjet me donatorët dhe partnerët;
- integrimin e masave në Programin Buxhetor Afatmesëm.

Ky proces mundëson fleksibilitet financiar dhe përshtatje të vazhdueshme të planit me nevojat reale dhe kapacitetet institucionale të Bashkisë.

Struktura e përgjithshme e kostove sipas fushave të ndërhyrjes

Bazuar në matricën e aktiviteteve të PVVBGJ 2026–2031, kostoja totale e planit vlerësohet në:

11,000,000 lekë

Ndarja sipas fushave të ndërhyrjes paraqitet si më poshtë:

Fusha e ndërhyrjes	Kosto (lekë)
Fusha I – Promovimi i të drejtave ekonomike dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave	3,000,000
Fusha II – Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe jetën publike	2,000,000

Fusha III – Mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje	4,000,000
Fusha IV – Integrimi gjinor në politikat dhe programet vendore	2,000,000
Totali i përgjithshëm	11,000,000

Table 1. Fushat e nderhyrjes

Përqindja e koston sipas fushave është:

Shpërndarja e koston së PVVBGJ 2026–2031

Ndarja e koston totale sipas katër fushave të nderhyrjes.




Figure 7. Përqindja e koston sipas fushave

Ndarja e kostove sipas burimit të financimit

Nga kostoja totale prej 11,000,000 lekësh, financimi parashikohet të sigurohet nga burimet e mëposhtme:

Burimi i financimit	Vlera (lekë)	Përqindja
Bashkia Mallakastër	4,400,000	40%
Donatorë dhe partnerë zhvillimorë	4,400,000	40%
Hendeku financiar i pambuluar	2,200,000	20%
Totali	11,000,000	100%

Table 2. Ndarja e koston sipas burimit

Burimet e financimit të PVVBGJ 2026–2031

Ndarja e kostos totale sipas burimeve të financimit.




Figure 8. Ndarja e kostos sipas burimit

Kostimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2031 përbën një instrument të rëndësishëm për planifikimin financiar, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin e progresit të politikave të barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër.

Vlera totale prej **11,000,000 lekësh** paraqet investimin minimal të nevojshëm për realizimin e objektivave të planit gjatë periudhës 2026–2031. Integrimi gradual i aktiviteteve në Programin Buxhetor Afatmesëm, mobilizimi i partnerëve zhvillimorë dhe sigurimi i fondeve shtesë do të jenë faktorë kyç për zbatimin e suksesshëm të planit dhe për arritjen e rezultateve të qëndrueshme në fushën e barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër.

7. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) kryhet në mënyrë të strukturuar dhe periodike, me qëllim garantimin e transparencës, llogaridhënies institucionale dhe përmirësimit të vazhdueshëm të politikave për barazinë gjinore në nivel vendor.

b.) Struktura e raportimit

Raportimi i aktiviteteve të zbatuara realizohet nga Drejtoritë ose Sektorët përgjegjës për zbatimin e masave përkatëse, të cilët raportojnë tek:

- **Komisioni për Barazinë Gjinore / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ**, i ngritur në nivel bashkie pas miratimit të planit;
- Grupi përbëhet nga përfaqësues dhe përfaqësues të të gjitha drejtorive të Bashkisë Mallakastër.

c.) Instrumentet e monitorimit

Menjëherë pas miratimit të PVVBGJ, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen:

- **Fletët e treguesve (indicator sheets)** për çdo aktivitet dhe objektiv specifik;
- Instrumentet për mbledhjen e të dhënave sipas indikatorëve të përcaktuar në plan;
- Formate standarde raportimi për njësitë zbatuese.

Këto instrumente sigurojnë një sistem të unifikuar të mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

d.) Frekuenca e raportimit

Raportimi do të realizohet në disa nivele:

- **Raportime periodike të aktiviteteve:** çdo 3 muaj (trimestrale), ose sipas kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore, Grupit të Monitorimit apo Kabinetit të Kryetarit/Kryetares së Bashkisë.
- **Raportime mbi objektivat specifikë:** çdo 6 muaj, me analizë më të thelluar të progresit dhe rezultateve të arritura.
- **Raporti vjetor i monitorimit:** përgatitet nga Bashkia dhe paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak.

e.) Roli i aktorëve institucionalë

Monitorimi i zbatimit të PVVBGJ kryhet nga:

- **Komisioni për Barazinë Gjinore**, si organ koordinues dhe mbikëqyrës;
- **Anëtarët e Këshillit Bashkiak**, të cilët ushtrojnë funksionin e kontrollit dhe vlerësimit politik të zbatimit;
- **Strukturat teknike të Bashkisë**, që sigurojnë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

f.) Shpërndarja e raporteve dhe transparenca

Raportet e monitorimit i përcillen:

- Këshillit Bashkiak;
- Aleancës së Grave Këshilltare;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), sipas nevojës;
- Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), sipas kërkesës.

Kjo siguron transparencë dhe koordinim ndërinstitutional në nivel vendor dhe qendror.

g.) Rishikimi i planit

Bazuar në rezultatet e monitorimit, PVVBGJ do të:

- rishikohet periodikisht sipas nevojës;

- përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme;
- përshtatet me ndryshimet në kontekstin social, ekonomik dhe institucional.

Rishikimi mund të realizohet edhe çdo vit, në varësi të progresit të zbatimit dhe prioritetëve të reja të Bashkisë. Sistemi i raportimit dhe monitorimit të PVVBGJ garanton një qasje të strukturuar, të matshme dhe transparente për ndjekjen e progresit të barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër, duke kontribuar në përmirësimin e politikave publike dhe forcimin e qeverisjes vendore gjithëpërfshirëse.

SHTOJCA 1

MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE (PVVBGJ) 2026–2031

Fusha Strategjike	Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi	Afati	Institucioni Përgjegjës	Partnerët	Kosto (Lekë)	Burim Financ
Fuqizimi ekonomik	Rritja e punësimit të grave	Organizimi i panairove të punës	12 panairove të realizuara	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Zyra e Punësimit	600,000	Bashki/D
Fuqizimi ekonomik	Rritja e aftësive profesionale	Trajnime profesionale për gratë	6 trajnime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	QFP, OJF	900,000	Donatorë
Fuqizimi ekonomik	Mbështetje për sipërmarrjen	Seanca këshillimi biznesi	12 seanca	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Biznese lokale	300,000	Bashki
Fuqizimi ekonomik	Informim mbi grantet	Takime informuese në NJA	18 takime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	AZHBR	300,000	Bashki
Fuqizimi ekonomik	Promovimi i grave sipërmarrëse	Aktivitet vjetor promovues	6 aktivitete	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Partnerë	900,000	Donatorë
Vendimmarrja	Rritja e lidershipit	Trajnime për gratë lidere	6 trajnime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	OJF	600,000	Donatorë
Vendimmarrja	Pjesëmarrja qytetare	Takime konsultative	24 takime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Këshillat Komunitarë	480,000	Bashki
Vendimmarrja	Angazhimi i vajzave	Forume rinore	6 forume	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Shkollat	420,000	Bashki
Vendimmarrja	Ndërgjegjësim publik	Fushata sensibilizuese	6 fushata	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Media lokale	500,000	Donatorë
Dhuna me bazë gjinore	Forcimi i mekanizmit të referimit	Takime koordinuese	72 takime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Policia, Shëndetësia	720,000	Bashki
Dhuna me bazë gjinore	Rritja e kapaciteteve	Trajnime ndërinstitucionale	6 trajnime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	OJF	900,000	Donatorë
Dhuna me bazë gjinore	Ndërgjegjësim komunitar	Fushata "16 Ditët"	6 fushata	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Partnerë	600,000	Donatorë
Dhuna me bazë gjinore	Mbështetje për viktimat	Këshillim dhe referim	180 raste	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Shërbimet Sociale	1,080,000	Bashki
Dhuna me bazë gjinore	Edukim në shkolla	Sesione ndërgjegjësuere	30 sesione	2026–2031	Bashkia Mallakastër	DAR	700,000	Bashki
Integrimi gjinor	Rritja e kapaciteteve	Trajnime për stafin	6 trajnime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	ASPA	600,000	Bashki
Integrimi gjinor	Buxhetimi gjinor	Punëtori institucionale	6 punëtori	2026–2031	Bashkia Mallakastër	MF	400,000	Bashki
Integrimi gjinor	Monitorimi i planit	Raporte monitorimi	6 raporte	2026–2031	Bashkia Mallakastër	Këshilli Bashkiak	500,000	Bashki
Integrimi gjinor	Statistika gjinore	Përditësimi i bazës së të dhënave	6 përditësime	2026–2031	Bashkia Mallakastër	INSTAT	500,000	Bashki

SHTOJCA 2

PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Objektivi	Treguesi	Burimi i të Dhënave	Frekuenca	Institucioni Përgjegjës
Rritja e punësimit të grave	Numri i grave të përfshira në programet e punësimit	Raportet e Bashkisë	Vjetore	Bashkia Mallakastër
Rritja e aftësive profesionale	Numri i grave të trajnuara	Raportet e trajnimeve	Vjetore	Bashkia Mallakastër
Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje	Numri i grave pjesëmarrëse në konsultime	Procesverbalet	6-mujore	Bashkia Mallakastër
Forcimi i mekanizmit të referimit	Numri i rasteve të trajtuara	Raportet e mekanizmit	Tremujore	Bashkia Mallakastër
Rritja e kapaciteteve institucionale	Numri i stafit të trajnuar	Raportet e trajnimeve	Vjetore	Bashkia Mallakastër
Zbatimi i buxhetimit gjinor	Numri i programeve me analizë gjinore	Dokumentet buxhetore	Vjetore	Drejtoria e Financës

SHTOJCA 3

TABELA E DETAJUAR E KOSTIMIT

Aktiviteti	Njësia	Numri	Kosto për Njësi	Kosto Totale (Lekë)
Panaire pune	Aktivitet	12	50,000	600,000
Trajnime profesionale	Trajnim	6	150,000	900,000
Seanca këshillimi biznesi	Seancë	12	25,000	300,000
Takime informuese	Takim	18	16,667	300,000
Aktivitet promovues	Aktivitet	6	150,000	900,000
Trajnime lidershpi	Trajnim	6	100,000	600,000
Takime konsultative	Takim	24	20,000	480,000
Forume rinore	Forum	6	70,000	420,000
Fushata sensibilizuese	Fushatë	6	83,333	500,000
Takime mekanizmi referimi	Takim	72	10,000	720,000
Trajnime ndërinstitucionale	Trajnim	6	150,000	900,000
Fushata "16 Ditët"	Fushatë	6	100,000	600,000
Shërbime këshillimi	Muaj	72	15,000	1,080,000
Sesione në shkolla	Sesion	30	23,333	700,000
Trajnime stafi	Trajnim	6	100,000	600,000
Punëtori buxhetimi gjinor	Punëtori	6	66,667	400,000
Raporte monitorimi	Raport	6	83,333	500,000
Përditësim database	Përditësim	6	83,333	500,000

Përmbledhje financiare

Fusha	Kosto (Lekë)
Fusha I	3,000,000
Fusha II	2,000,000
Fusha III	4,000,000
Fusha IV	2,000,000
TOTALI	11,000,000

SHTOJCA 4

LISTA E INSTITUCIONEVE DHE PARTNERËVE

Institucionet dhe organizatat e përfshira në zbatimin dhe monitorimin e PVVBGJ 2026–2031 janë:

- Këshilli Bashkiak Mallakastër
- Prefektura e Qarkut Fier
- Drejtoria Vendore e Policisë Fier
- Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier
- Qendrat Shëndetësore të Bashkisë Mallakastër
- INSTAT
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
- Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e Bashkisë Mallakastër.
- Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët që mbështesin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Institucionet arsimore publike dhe komuniteti i biznesit lokal.

